

## **BULETINI SHKENCOR**

Botim i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, Shqipëri

**Adresa:** Buletini Shkencor i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, Shqipëri  
Shëtitorja “Rilindasit”, Korçë, Shqipëri  
buletinishkencor@unkorce.edu.al

### **UDHËZIME PËR AUTORËT**

Buletini Shkencor boton punime origjinale të shkruara në gjuhën shqipe ose angleze në shkencat shoqërore dhe shkencat natyrore. Kjo revistë boton vetëm punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për përparimin e shkencës. Revista drejtohet prej Këshillit Botues të përbërë nga 12 anëtarë. Rektori i Universitetit është Kryetar i Këshillit Botues.

Preferohet që punimet të paraqiten në gjuhën angleze, por mund të jenë edhe në shqip sipas interesit të autorëve. Punimet që pranohen nënkuptojnë që puna e paraqitur nuk është botuar më parë, nuk është dërguar për t’u botuar në ndonjë organ tjetër dhe botimi është aprovuar nga të gjithë autorët, të cilët i kanë transferuar më parë revistës sonë të drejtën e botimit. Përveç këtyre punimi i pranuar i është nënshtruar procesit të recensimit. Punimet duhet të jenë origjinale dhe të kontribuojnë në përparimin e dijes në fushën e caktuar të shkencës. Plagjiatura nuk lejohet dhe do t’u raportohet autoriteteve përkatëse. Konkluzionet duhet të justifikohen nga skema eksperimentale dhe të dhënat e paraqitura. Shkrimi duhet të jetë i qartë, konçiz dhe korrekt nga ana gramatikore. Autorët mbajnë përgjegjësi për anën shkencore dhe formale të materialeve që paraqesin si dhe për çdo korrespondencë me redaktorët, artikulli duhet të jetë i redaktuar.

### **I. ORGANIZIMI I PUNIMIT**

- Punimi duhet të shkruhet në *Microsoft® Office Word*, në formatin word 2007, A4, me një hapësirë *Normal* në të gjitha anët, fonti duhet të jetë *Times New Roman*, single space me madhësi 12 dhe të mos i kalojë 11 faqe.
  - Dorëshkrimi nuk duhet të ketë footnotes apo endnotes. Referencat duhet të jenë pjesë e tekstit (Mbiemër, vit: fq) dhe të bëhen sipas modelit të sistemit APA.
  - Faqet duhet të numërohen, faqja e parë duhet të ketë titullin si dhe emrat dhe adresat e autorëve.
  - Përmbledhja është e detyruar të jetë në dy gjuhët shqip dhe anglisht. Punimi përbëhet nga këto elemente: “*titulli, përmbledhja, fjalët celës, hyrje, materiali dhe metoda, rezultatet, diskutimi, konkluzionet, referencat, tabelat, grafiket dhe figurat*”. Këta elemente duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
1. **Titulli:** Titulli i punimit duhet të jetë jo i gjatë, i qartë dhe informues. Pas tij vendosen emrat e autorëve, institucionet përkatëse dhe adresat e plota të tyre. Grada apo titulli shkencor i autorëve nuk është i domosdoshëm për t’u vendosur. Emri i autorit që do të mbajë korrespondencën duhet të ketë një asterisk.

2. **Përmbledhja** paraqet thelbin e punimit dhe përfundimet që arrihen në të. Përmbledhja duhet të paraqitet në dy gjuhë, anglisht dhe shqip. Ajo nuk duhet të jetë më shumë se 150 fjalë për secilën nga gjuhët. Shënimet dhe referencat në të nuk lejohen.
3. **Fjalët çelës:** Punimi duhet të ketë 4-5 fjalë çelës të cilat pasqyrojnë thelbin e punimit.
4. **Hyrja** duhet të përshkruajë shkurt bazën për punën e paraqitur, si dhe punën shkencore të mëparshme të paraqitur me anë të referencave në mënyrë të përshtatshme. Në hyrje tregohen objektivat dhe arsyet e ndërmarrjes së studimit, struktura e punimit si dhe shkurtimisht rezultatet e marra dhe diskutimet e kryera dhe të rejtat që sjell punimi.
5. **Materiali dhe Metoda** duhet të paraqiten në mënyre të detajuar. Këtu paraqiten metodat e ndryshme të përdorura në studim si dhe ato statistikore. Informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm që të lejojë referimet.
6. **Rezultatet** duhet të jenë të qarta dhe të ilustruara në tabela dhe grafikë. Rezultatet eksperimentale duhet të analizohen statistikisht dhe të nxirren përfundime në bazë të një besueshmërie statistikore. Të njëjtat rezultate të dhëna me tabela nuk mund të jepen edhe me anën e grafikëve dhe anasjelltas.
7. **Diskutimet:** Përfundimet që vijnë nga rezultatet e paraqitura duhet të diskutohen në mënyrë të plotë dhe të lidhen direkt dhe të mbështeten në rezultatet e arritura. Përfundimet nuk duhet të jenë spekulative apo të merren prej literaturës apo njohurive të përgjithshme e spontane.
8. **Referencat:** Burimet e literaturës duhet të listohen në mënyre alfabetike në bazë të mbiemrit të autorit të parë.

Shembull i referimit të një artikulli

Mbiemër, Emër. "Titull". *Revista, buletini*, Vol....., No....., datë, fq.

Shembull i referimit të një libri

Mbiemër, Emër. (viti i botimit). *Titulli*, vendi i bot:shtepia botuese.

9. **Tabelat:** Çdo tabelë duhet të ketë numrin si dhe titullin e saj. Numri i faqes ku fillojnë tabelat do të jetë në vazhdim të numrit të faqes së fundit ku mbaron referenca.
10. **Figura ose Grafikë:** Dorëshkrimi mund të përmbajë figura ose/dhe grafikë. Numri i faqes ku këto fillojnë do të jetë në vazhdim të numrit të faqes ku mbarojnë tabelat. Figurat dhe grafikët duhet të kenë numra dhe tituj.

Dorëshkrimet nga fushat e shkencave shoqërore mund të mos përmbajnë elementet 5 dhe 6 në mënyrën e paraqitur me sipër.

Dorëshkrimet të cilat nuk i përgjigjen formatimit të mësipërm nuk do të merren në konsideratë.

## II. PROCEDURA E PRANIMIT

Autorët duhet të dergojnë me rrugë elektronike punimin si dhe një *kërkesë drejtuar Këshillit Botues* ku shprehet dëshira për botimin e punimit në adresën: **buletinishkencor@yahoo.com**. Gjithashtu autorët duhet të dergojnë *dy kopje të printuara të punimit dhe dokumentin e transferimit të së drejtës së autorit për publikim*, sipas formatit të dhënë më poshtë në adresën: Buletini Shkencor, Universiteti “Fan S. Noli”, Shëtitorja Rilindasit, Korçë, Shqipëri. Dorëshkrimet do të vlerësohen nga reçensentë, identiteti i të cilëve nuk u bëhet i ditur autorëve. Këshilli Botues në bazë të rekomandimeve të reçensentëve, merr vendimin përkatës dhe u komunikon vendimin autorëve. Autorët marrin përgjigje për vendimin e Këshillit Botues brenda një periudhe tre mujore nga dergimi i materialit.

## FORMULAR

### Për transferimin e të drejtës së autorit për publikim

**Titulli i punimit**

---

---

**Fusha e Studimit**

---

## DEKLARATË

Deklaroj/jmë transferimin e të drejtës së autorit për botim, të punimit me titullin e mësipërm, tek Buletini Shkencor i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, të cilit i njohim të drejta të plota për botimin dhe përhapjen e tij në perputhje me rregullat e publikuara prej Këshillit Botues të këtij Buletini.

Emri, Mbiemri i autorit/rëve	Firma	Datë

**Shenim:** Kjo deklaratë duhet të firmoset nga të gjithë autorët

**Autori me të cilin do të mbahet korrespondenca:**

**Emri , Mbiemri :** .....

**Adresa :** .....

**Tel:** .....

**E-mail:** .....